



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 5 qershor 2017  
Nr. ref.: RK 1081/17

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI141/16**

Parashtrues

**Agrounion sh.p.k**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, KA. nr. 339/2016, të 15 prillit 2016, dhe Njoftimit të Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, KMLK. nr. 7/16, të 29 korrikut 2016**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Agrounion” përmes drejtorit gjeneral të saj, Refik Shabani (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me seli në Sllatinë të Madhe, komuna e Fushë-Kosovës, e përfaqësuar nga avokati Bahtir Troshupa.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, KA. nr. 339/2016, të 15 prillit 2016, së bashku me Njoftimin e Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, KMLK. nr. 7/16, të 29 korrikut 2016.
3. Njoftimi i Kryeprokurorit të Shtetit i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 1 gusht 2016.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit të Kosovës së bashku me Njoftimin e Kryeprokurorit të Shtetit.
5. Parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e mbrojtura me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

6. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

7. Më 1 dhjetor 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 16 janar 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.
9. Më 13 shkurt 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit në Prishtinë.
10. Më 14 mars 2017, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës.
11. Më 21 mars 2017, Gjykata i kërkoi parashtruesit të japë sqarime shtesë lidhur me kërkesën dhe të dorëzojë dokumente shtesë lidhur me autorizimin.
12. Më 30 mars 2017, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi dokumentin shtesë dhe iu përgjigj kërkesës së Gjykatës.

13. Më 3 maj 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

14. Më 10, 15, dhe 17 prill 2014, Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë kreu një inspektim treditör të punës së parashtruesit të kërkesës dhe përpiloi gjashtë dokumente për gjendjen e gjetur (Procesverbalet nr. 003615, 003616, 003619, 003620, 003625 dhe 003626 të 10, 15, dhe 17 prillit 2014).
15. Më 28 prill 2014, në bazë të procesverbaleve të lartpërmendura, Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë paraqiti kërkesë për inicimin e procedurës së kundërvajtjes kundër parashtruesit në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Divizioni për kundërvajtje. Në kërkesën e Agjencisë së Ushqimit dhe të Veterinarisë theksohej se parashtruesi i kërkesës
- “ka vendosur në treg në territorin e Republikës së Kosovës, Preparate për Mbrojtjen e Bimëve (PMB), që nuk janë të autorizuara ose që nuk kanë pasur certifikatë të autorizimit të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e natyrisht që nuk kanë qenë të përfshira në Regjistrin - listën e PMB-ve të lejuara për qarkullim dhe përdorim në Kosovë.”*
16. Më 14 dhjetor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin Reg. nr. 26553/14 e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kundërvajtjet dhe e dënoi me gjobë prej 6.000 €.
17. Më 8 janar 2016, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke theksuar se gjykata nuk i kishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës të gjitha dokumentet dhe procesverbalet nga seancat.
18. Më 15 janar 2016, Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin Ka. nr. 28/2016 e anuloi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe e ktheu rastin në rigjykim.
19. Më 31 mars 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin Reg. nr. 26553/14, në rigjykim, e shpalli parashtruesin fajtor dhe dënoi me gjobë prej 6.000 €.
20. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke theksuar se aktvendimi ishte nxjerrë me *“abuzim me funksionin gjyqësor nga gjyqtarja”* dhe se kishte ndodhur *“parashkrimi absolut të kundërvajtjes së dyshuar”*.
21. Më 15 prill 2016, Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin KA. nr. 339/2016 e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktvendimin Reg. nr. 26553/14 e Gjykatës Themelore në Prishtinë.
22. Më 22 korrik 2016, parashtruesi i kërkesës i drejtua Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës duke kërkuar inicimin e kërkesës për mbrojtje të

ligjshmërisë kundër aktvendimit përfundimtar të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

23. Më 29 korrik 2016, Kryeprokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës me Njoftimin KMLK. nr. 7/16 e njoftoi parashtruesin e kërkesës që:

*“Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe propozimit tuaj, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ju njofton se nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme ligjore për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

24. Parashtruesi i kërkesës përshkruan gjerësisht gjendjen faktike dhe pretendon një numër të shkeljeve të Ligjit për procedurën kundërvajtëse në lidhje me të drejtat e tij. Këto pretendime kanë të bëjnë me njoftimin jo të rregullt lidhur me seancat dhe dorëzimin e dokumenteve; parashkrimin absolut të kundërvajtjeve, tejkalimin e akuzave lidhur me kundërvajtjen. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës këto shkelje të pretenduara nuk i ndërlihdh me ndonjë shkelje kushtetuese konkrete.
25. Parashtruesi i kërkesës, më tej, pretendon se është shkelur parimi *reformatio in peius*. Parashtruesi i kërkesës e arsyeton këtë pretendim me faktin se është dënuar për kundërvajtje të kryera në tre ditët kur u bë inspektimi dhe se *“... nuk ka pasur kërkesë për fillimin e procedurës për dyshime të kundërvajtjes të kryer me datë 15 prill 2014 dhe 17 prill 2014”.*
26. Parashtruesi i kërkesës pohon se Gjykata e Apelit e dënoi atë për kundërvajtjet e kryera në ditë të tjera dhe jo për kundërvajtjet për të cilat parashtruesi ishte dënuar fillimisht, ashtu që akuzat u ndryshuan në dëm të parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kjo nuk ishte brenda fushëveprimit të juridiksionit të Gjykatës së Apelit, pasi që vetë ankesa ishte paraqitur nga parashtruesi i kërkesës dhe jo nga prokurori.
27. Në fund, parashtruesi i kërkesës thekson se *“... pavarësisht që në Kushtetutë dhe Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut shprehimisht nuk flitet për parimin reformatio in peius, në esencë, parimet kushtetuese dhe parimet e KEDNJ-së e përmbajnë në vetvete këtë parim. Andaj konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij të përcaktuara me parimin reformatio in peius e rrjedhimisht të garantuara me Kushtetutë neni 21 -Parimet e Përgjithshme, dhe nga neni 31/E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm/të Kushtetutës si dhe është shkelur dhe neni 6 i KEDNJ e drejta për proces të rregullt/Gjykim të Drejtë”.*
28. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që:
- “Të SHPALLË, të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës se Apelit KA. nr. 339/2016 të datës 15.04.2016 dhe ta KTHEJË [...] në Rigjykim në Gjykatën e Apelit lëndën ...”.*

## Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.
30. Fillimisht, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:
- “1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.  
[...]  
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
31. Më tej, Gjykata i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:
- “4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”*
32. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:
- “Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*
33. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (a) të Rregullores së punës, i cili parasheh që:
- “(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:  
[...]  
d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
- (2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:  
[...]  
(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie”.*
34. Gjykata së pari konsideron se, në bazë të nenit 21.4 të Kushtetutës që parasheh se *“të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme,”* parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të parashtrtojë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në të drejtat kushtetuese që vlejné për individët dhe që janë të zbatueshme edhe për personat juridikë siç është parashtruesi i kërkesës.
35. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe e ka

parashtruar kërkesën brenda afatit të përcaktuar. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë më tej nëse janë përmbushur kushtet e përcaktuara me nenin 48 të Ligjit dhe të parapara me rregullin 36 të Rregullores së punës.

36. Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit kanë të bëjnë me shkelje të pretenduara të ligjit, përkatësisht me informimin jo të rregullt lidhur me seancat dhe dorëzimin e dokumenteve; me parashkrimin absolut të kundërvajtjeve; me tejkalimin e akuzës lidhur me kundërvajtjen dhe parimin *reformatio in peius*.
37. Gjykata vëren se parashtruesi, në esencë, përsërit të njëjtat shkelje të pretenduara të cilat i ka ngritur gjatë procedurave në gjykatat e rregullta. Në procedurat e përsëritura, Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit i morën parasysh ato, i korrigjuan shkeljet e pretenduara dhe i arsyetuan detajisht vendimet e tyre.
38. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për “*informimin jo të rregullt lidhur me seancat dhe dorëzimin e dokumenteve* (Aktvendimi KA. nr. 339/2016) Gjykata e Apelit dha përgjigje të detajuar, duke arsyetuar si vijon:

*“... pas këtij refuzimi të nesërmen paraqitet në gjykatë e pranon ftesën dhe me dt.25.03.2016 paraqet kërkesë për shtyrje të seancës me të njëjtin arsyetim. Gjyqtarja duke pasur parasysh tendencën e avokatit në zvarritje të procedurës, gojarisht e ka njoftuar avokatin se nuk do të ketë shtyrje të seancës, mirëpo i njëjti përkundër kësaj nuk është paraqitur në gjykatë me dt.30.03.2016, ndërsa dëshmitarët e propozuar për dëgjim nga ana e tij kanë prezantuar”.*

39. Më tej, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për “*parashkrimin e kundërvajtjeve dhe tejkalimit të akuzës lidhur me kallëzime penale*”, si dhe në lidhje me pretendimin e tij se “*Gjykata e ka të njohur faktin se nuk ka kërkesë për fillimin e procedurës për dyshime të kundërvajtjes të kryer me datë 15 prill 2014 dhe 17 prill 2014.*” Gjykata vëren se Gjykata e Apelit dha përgjigje të detajuar në lidhje me këto pretendime, duke arsyetuar:

*“... Pretendimet nga ankesa, se kundërvajtja e supozuar është kryer me dt.10.04.2014 dhe rrjedhimisht ka arritur parashkrimi i të drejtës për zhvillimin e procedurës-nuk qëndron sepse më dt. 15.04.2014 e gjithashtu edhe më dt. 17.04.2014 në vazhdimësi është kryer kontrollimi inspektues dhe me procesverbale është konstatuar kundërvajtja e kryer nga e pandehura. Gjithashtu, kërkesa për fillimin e procedurës për kundërvajtje e dt.29-30.04.2016 e ngarkon të pandehurën për kryerje të kundërvajtjes, pos për dt.10.04.2016, edhe për dt. 15.04.2016 procesverbalet e inspektimit nr.003619 dhe 003620. dhe për dt.17.04.2016 procesverbalet e inspektimit nr.003625 dhe 003626. kështu që nuk qëndron as pretendimi nga ankesa, se Gjykata e shkallës së parë, për sa i përket datës së kryerjes së kundërvajtjes, ka vepruar në kundërshtim me kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje ...”.*

40. Në fund, Gjykata vëren se edhe pretendimet për shkelje të parimit *reformatio in peius*, për shkak të shqiptimit të dënimit më të lartë edhe pse ankesa ishte

ushtruar nga vetë parashtruesi i kërkesës, morën përgjigje nga Gjykata e Apelit si në vijim:

“... Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë zhvillimit të procedurës kundërvajtje nuk ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, përkatësisht nuk ka bërë zbatim të gabuar të dispozitave të së drejtës materiale në dëm të pandehurës, kurse sa i përket lartësisë së dënimit të shqiptuar konsiderohet se në vështrim të nenit 9 të LK, i është shqiptuar nën minimumin e paraparë ligjor, andaj edhe në këtë drejtim nuk ka bazë ligjore për ndryshimin e aktvendimit dhe pezullimin e procedurës kundërvajtje për shkak të parashkrimit, siç propozohet në ankesën e ushtruar”.

41. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit apo të ligjit, që pretendohet të janë kryer nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç nëse ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë pretendime të dëshmuara dhe argumente bindëse me rastin e pohimit se autoriteti publik i ka cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë.
42. Gjykata rikujton se nuk është roli i saj të vërtetojë se cilat lloje të provave janë të lejuara dhe cilat prova duhet të merren parasysh dhe as të specifikojë se cilat prova janë të pranueshme dhe cilat nuk janë. Ky është roli i gjykatave të rregullta. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të konstatojë nëse procedurat në tërësi ishin të drejta, duke përfshirë mënyrën e marrjes së provave (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 12 majit 2000, *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 35394/97, paragrafët 34-35).
43. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu thekson se roli i Gjykatës Kushtetuese është të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe rrjedhimisht nuk mund të veprojë si “*gjykatë e shkallës së tretë ose të katërt*” (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96; shih gjithashtu Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, të 16 dhjetorit 2011, nr. KI70/11, parashtruesit e kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*).
44. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës kishte mundësi të paraqesë para gjykatave të rregullta arsyet materiale dhe juridike për zgjidhjen e kontestit. Gjykata po ashtu konsideron se argumentet e parashtruesit të kërkesës janë dëgjuar dhe shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat e rregullta dhe vendimet e marra ishin plotësisht të arsyetuara.
45. Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me përfundimin e procedurës në gjykatat e rregullta. Megjithatë, thjesht mospajtimi me rezultatin e procedurave të zhvilluara nga gjykatat e rregullta nuk mund të ngrejë vetvetiu një pretendim të argumentueshëm për shkelje të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rasti *Mezotur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

46. Gjkata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka prezantuar pretendim preciz dhe konkret se cilat të drejta pretendohet të jenë cenuar dhe nuk ka shpjeguar si dhe pse Aktvendimi i Gjykatës së Apelit mund të ketë shkelur këto të drejta kushtetuese. Parashtruesi i kërkesës vetëm ka theksuar se ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese. Ai nuk ka ofruar ndonjë provë *prima facie* e cila do të tregonte shkelje të të drejtave kushtetuese (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 31 majit 2005, *Vanek kundër Republikës Sllovaqe*, nr. 53363/99).
47. Gjkata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar pretendimet se procedurat përkatëse kanë qenë të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimet e kontestuara parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 30 qershorit 2009, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06).
48. Për këto arsye, Gjkata konsideron se nuk janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
49. Prandaj, Gjkata konkludon se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, si qartazi e papabazuar në baza kushtetuese.

### PËR KËTO ARSYE

Gjkata Kushtetuese e Kosovës, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit dhe rregullave 36 (2) a) dhe 56 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 3 maj 2017, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

  
Snezhana Botusharova

  
Arta Rama-Hajrizi

